UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 137, datë 15.7.2026

PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET STRUKTURAVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT DHE SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, PËR PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 33, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit dhe drejtori i Shërbimi Informativ të Shtetit,

UDHËZOJNË:

I. AUTORITETET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse që bashkëpunojnë në procesin e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (më poshtë "MPB") – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (më poshtë "DKM");

b) Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit (më poshtë "MEI") – Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (më poshtë "AKPA");

c) Shërbimi Informativ i Shtetit (më poshtë "SHISH").

II. DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR LEJE QËNDRIMI OSE LEJE UNIKE

1. Aplikimi për leje qëndrimi, apo për ripërtëritje të këtij dokumenti, bëhet *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania* nga vetë i huaji. Aplikimi për leje unike apo ripërtëritje të këtij dokumenti, bëhet nga vetë i huaji, punëdhënësi ose agjencia private e punësimit e licencuar me autorizimin e shtetasit të huaj ose punëdhënësit dhe i drejtohet autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin që mbulon territorin, ku i huaji kryen ose do të kryejë aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Për procesimin e aplikimeve për leje qëndrimi ose leje unike, të dhënat përpunohen dhe replikohen ndërmjet tri sistemeve elektronike:

a) Sistemi *e-Visa* (VISA);

b) Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP);

c) Sistemi FER – Moduli *e-Leje* qëndrimi (FER).

3. Në varësi të shtetësisë dhe të motivit të qëndrimit të përzgjedhur në aplikim, të dhënat e shtetasit të huaj, përfshirë dokumentacionin ligjor aksesohen nga sistemet, si më poshtë:

a) Kërkesat për leje qëndrimi për motive bashkimi familjar/studim/të tjera, aksesohen nga sistemet FER dhe VISA (nëse është kategori shtetësie që ka nevojë për vizë D);

b) Aplikimet për leje unike, aksesohen nga sistemet FER, SSHP, VISA (kur bën pjesë në kategoritë e shtetësisë që kanë nevojë për vizë të tipit D).

III. APLIKIMI PËR LEJE QËNDRIMI

1. Për kategoritë e të huajve që kanë nevojë për vizë tipi D, për t'u trajtuar me leje qëndrimi, aplikimi i depozituar në portalin qeveritar *e-Albania* aksesohet njëherësh nga sistemet VISA dhe FER.

2. Në sistemin VISA, aplikimi procesohet në përputhje me udhëzimin e përbashkët, midis ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrit të Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit. Në përfundim të vlerësimit, krahas njoftimit *online* të shtetasit të huaj, njoftohet MEI dhe autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin (DVKM) nëpërmjet sistemit *online* mbi miratimin/refuzimin e vizës tipi D për aplikantin e huaj. Në sistemin FER, aplikimi

mbetet në statusin "në pritje", deri në momentin kur i huaji hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me vizë të tipit D.

3. Struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, brenda 1 (një) ditë pune, shqyrton aplikimin/dokumentacionin e ngarkuar në portalin unik qeveritar *e-Albania* për leje qëndrimi ose për ripërtëritjen e saj. Në rastet kur kërkohet miratimi i vizës nga MEPJ-ja, pasi shtetasi i huaj ka hyrë në territor dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton në përputhje me kriteret ligjore, kjo strukturë e pajis atë me leje provizore me afat 1-mujor (njëmujor), e cila i dërgohet automatikisht në adresën elektronike të deklaruar në formularin e aplikimit *online*.

4. Në rastet kur nga shtetasi i huaj kërkohet në rrugë elektronike shtyrja e afatit të lejes provizore, drejtuar strukturës pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, kjo strukturë e pajis shtetasin e huaj me leje provizore të shtyrë, me një afat jo më shumë se 30 ditë. Lista me aplikimet e pranuara nga specialistët e migracionit DVKM-së, nëpërmjet një procedure të automatizuar i kalon për shqyrtim shefit të Sektorit të Migracionit të DVKM-së në sistemin FER, i cili, pas vlerësimit, ia përcjell për miratim drejtuesit të drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin.

5. Specialisti i migracionit që trajton rastin, brenda 1 (një) dite pune, vlerëson aplikimin dhe komunikon me aplikantin nëpërmjet postës elektronike të portalit qeveritar (FER – aplikime *online),* sipas rasteve, si vijon:

a) nëse konstaton se informacioni apo dokumentacioni i ngarkuar nga aplikanti është i paplotë, njofton të huajin për mangësitë e konstatuara dhe i kërkon plotësimin dhe ngarkimin e tyre *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania,* tek opsioni "Dokumentacion plotësues", brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike;

b) nëse konstaton se nuk janë përmbushur kriteret ligjore, njofton aplikantin mbi refuzimin e kërkesës për mospërmbushje të kritereve ligjore.

6. Mosplotësimi i dokumenteve të munguara brenda afateve të përcaktuara, sjell refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi.

7. Struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin pranon aplikimin e të huajit për leje qëndrimi, brenda afateve të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, dhe në përputhje me kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

8. Nëse rezulton se i huaji, në raste specifike të përcaktuara në pikën 1, shkronja "a", dhe në pikën 2, të nenit 34, të ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", të ndryshuar, nuk ka përmbushur kriteret e hyrjes dhe të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, i komunikon mospërmbushjen e kriterit dhe i kërkon të përcjellë nëpërmjet postës elektronike arsyen dhe dokumentacionin përkatës, që justifikon shkeljen e kriterit ligjor.

9. Për të huajt që përmbushin kriteret sipas nenit 52, nenit 53, dhe shkronjës "dh", të pikës 1, të nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, aplikimi për leje qëndrimi dhe dokumentacioni i nevojshëm ligjor, përcillet me shkresë zyrtare nga autoriteti përgjegjës që trajton kategoritë specifike të të huajve, në përputhje me këto nene, pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin. Kërkesa hidhet manualisht në sistemin FER nga specialisti i migracionit dhe përcillet për vlerësim në strukturat përkatëse. Pas miratimit të lejes së qëndrimit, njoftimi i dërgohet zyrtarisht autoritetit që ka sjellë kërkesën për pajisjen me leje qëndrimi, i cili e njofton të huajin për vijimin e procedurave të mëtejshme.

10. Në rast se i huaji deklaron në formularin e aplikimit *online* për leje qëndrimi se ka qenë i dënuar në vendin e origjinës, specialisti i migracionit, nëpërmjet postës elektronike të portalit qeveritar, i përcjell të huajit njoftimin për të depozituar nëpërmjet postës elektronike të portalit, dëshminë e penalitetit me vulë apostile të lëshuar në 6-mujorin (gjashtëmujorin) e fundit, të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Specialisti i migracionit kërkon që dëshmia penale origjinale të dorëzohet pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin nëpërmjet shërbimit

postar. Në rastet kur dëshmia e penalitetit përmban të dhëna për krime kundër familjes, krime seksuale, sidomos kundër fëmijëve, të vlerësohet nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin nëse përmbushen kushtet për vazhdimin e procedurës së mëtejshme. Nëse dëshmia e penalitetit nuk dorëzohet, aplikimi për leje qëndrimi refuzohet dhe nga ana e specialistit bëhen shënimet në FER.

11. Pas pranimit të aplikimit për leje qëndrimi dhe regjistrimin e aplikimit në modulin *e-Leje* qëndrimi, i huaji, brenda 1 (një) dite pune, pajiset me leje qëndrimi provizore në formatin elektronik, me afat vlefshmërie 1 (një) muaj, deri në marrjen e përgjigjes mbi aplikimin e dorëzuar. Në rastet e shtyrjes së këtij afati për arsye administrative, zyra pritëse në autoritetin vendor për kufirin dhe migracionin njofton të huajin për datën e re të përgjigjes, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Lista me aplikimet e pranuara nga specialistët e migracionit, nëpërmjet një procedure të automatizuar i kalon për shqyrtim shefit të Sektorit të Migracionit në sistemin FER, që, pas vlerësimit, ia kalon për miratim drejtuesit të drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin. Leja provizore e miratuar i dërgohet automatikisht të huajit në adresën elektronike që ka vendosur në formularin e aplikimit *online*.

12. Në rast të refuzimit të aplikimit për leje qëndrimi, pagesa e tarifës është e pakthyeshme, pasi mbulon shërbimin e kryer.

13. Në rastet kur nga institucioni i interesuar bëhet një kërkesë për pajisjen e të huajit me leje qëndrimi, aplikimi nuk kryhet nëpërmjet depozitimit të kërkesës *online* në portalin qeveritar, por duhet të depozitohet në formë shkresore pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin. Kërkesa hidhet manualisht në sistemin FER nga specialisti i migracionit dhe përcillet për vlerësim në strukturat përkatëse.

IV. APLIKIMI PËR LEJE UNIKE

1. Për kategoritë e shtetasve të huaj që aplikojnë për herë të parë për leje unike dhe që kanë nevojë për vizë tipi D, aplikimi i depozituar në portalin unik qeveritar e-*Albania* aksesohet njëherësh nga sistemet SSHP, VISA dhe FER.

2. Aplikimi për leje unike shqyrtohet nga autoriteti vendor i kufirit dhe migracionit, ku i huaji ushtron aktivitetin, me përjashtim të punonjësve lëvizës digjitalë, të cilët aplikojnë aty ku kanë vendqëndrimin.

3. Të gjitha aplikimet për leje unike të të huajve, për të cilat sipas legjislacionit në fuqi kërkohet miratim për punësim nga AKPA-ja, aksesohen nga sistemi SSHP.

4. Në sistemin SSHP, aplikimi i të huajit që kërkon të punësohet/vetëpunësohet në Republikën e Shqipërisë, shqyrtohet në zbatim të legjislacionit në fuqi për të huajt dhe, nëse konstatohet se:

a) informacioni apo dokumentacioni i ngarkuar është i paplotë: i huaji njoftohet brenda 1 (një) ditë pune për mangësitë e konstatuara dhe i kërkohet plotësimi i tyre brenda një periudhe 1-javore (njëjavore);

b) informacioni dhe dokumentacioni janë të plotë ose pasi janë plotësuar, autoriteti përgjegjës, brenda 1 (një) dite pune, vlerëson përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore, dhe vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës;

c) në rast refuzimi për shkak të mospërmbushjes së kritereve ligjore, aplikanti njoftohet për vendimin e marrë, duke cituar dispozitën përkatëse të legjislacionit në fuqi.

5. Në përfundim të vlerësimit, krahas njoftimit *online* të të huajit, njoftohen edhe strukturat përkatëse në sistemet VISA dhe FER *online,* mbi miratimin apo refuzimin e kërkesës së punësimit/vetëpunësimit për aplikantin e huaj. Në sistemin VISA aplikimi mbetet në statusin "në pritje" deri në momentin e miratimit të punësimit, ndërsa në sistemin FER aplikimi mbetet në statusin "në pritje", deri në momentin që i huaji hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me vizë tipi D.

V. PRANIMI I APLIKIMIT PËR LEJE QËNDRIMI OSE LEJE UNIKE

1. Pranimi i dokumentacionit të saktë për leje qëndrimi ose leje unike është përgjegjësi e strukturës pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, referuar përcaktimeve në ligjin nr. 79/2021, "Për të huajt", i ndryshuar.

2. Pranimi i dokumentacionit, përfshin:

a) përputhshmërinë me dokumentacionin dhe përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) përmbushjen e kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar;

c) konsultimet me baza të tjera të dhënash;

ç) trajtimin e kërkesave specifike rast pas rasti.

3. Në rast të aplikimit për leje qëndrimi/leje unike apo rinovim të tyre dhe aplikimi është bërë jashtë afateve të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, struktura e migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin vlerëson besueshmërinë e arsyeve të tejkalimit të afateve që paraqet shtetasi i huaj dhe vendos vijimin e procedurës me masë administrative sipas përcaktimeve në shkronjën "a/i", pika 1, e nenit 141, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar. Arsyeja e tejkalimit të afateve për aplikim, si dhe masa administrative e marrë, shënohen si "koment" në modulin *e-Leje* qëndrimi.

4. Në rast se aplikimi për leje qëndrimi/leje unike apo rinovim është bërë jashtë afateve të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, struktura e migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin vlerëson se arsyet nuk justifikojnë moskryerjen e aplikimit në afat, refuzon aplikimin, dhe njofton shtetasin e huaj për arsyet e refuzimit të aplikimit. Arsyet e refuzimit reflektohen në rubrikën shënime në FER.

5. Personat, sipas parashikimeve të nenit 52, nenit 53 dhe shkronjës "dh", të pikës 1, të nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, përjashtohen nga aplikimi i masave ndëshkimore, në zbatim të procedurave të pranimit të aplikimit për leje qëndrimi dhe rinovimin e saj.

VI. VLERËSIMI I APLIKIMIT PËR LEJE QËNDRIMI OSE LEJE UNIKE

1. Në vlerësimin e aplikimit për leje qëndrimi ose leje unike marrin pjesë strukturat përgjegjëse të autoritetit vendor dhe qendror të kufirit dhe migracionit, strukturat përgjegjëse të informacionit kriminal në Policinë e Shtetit, si dhe strukturat përgjegjëse të Shërbimit Informativ të Shtetit.

2. Strukturat përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, sipas fushës së përgjegjësisë dërgojnë lejen provizore elektronikisht tek i huaji, si dhe dërgojnë, brenda 2 (dy) ditëve pune, për vlerësim, në formë elektronike pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, çdo aplikim të miratuar nga autoritet vendore për kufirin dhe migracionin, duke bërë komentet përkatëse në modulin *e-Leje* qëndrimi të sistemit FER.

3. Struktura e migracionit në autoritetin qendror për kufirin dhe migracionin trajton aplikimet në sistem, kryen verifikime të dokumenteve për raste ku kërkohet vlerësim i veçantë, duke proceduar rast pas rasti. Struktura e migracionit, brenda 2 (dy) ditëve pune dërgon elektronikisht për vlerësim tek strukturat përgjegjëse të SHISH-it dhe Departamentit të Policisë Kriminale, pranë autoritetit qendror të Policisë së Shtetit të gjitha aplikimet e dërguara nëpërmjet sistemit FER nga autoriteti vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

4. Struktura përgjegjëse e Departamentit të Policisë Kriminale pranë autoritetit qendror të Policisë së Shtetit dhe strukturat përgjegjëse të SHISH-it, të ngarkuar për këtë qëllim, kryejnë verifikimet e nevojshme në bazat e tyre të të dhënave ndaj të huajve, të cilët kanë aplikuar për leje qëndrimi ose leje unike dhe bëjnë vlerësimin e tyre nëse janë dakord apo jo për lëshimin e lejes, brenda 5 ditëve pune në rastin e lejeve unike dhe 7 ditë pune në rastet e lejeve të qëndrimit. Në rastet e vlerësimit negativ për lëshimin e saj, autoritetet e sipërcituara ia komunikojnë me shkresë zyrtare autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin referencën ligjore mbi të cilën

bazojnë vendimin për refuzimin e aplikimit, si dhe afatin e refuzimit të hyrjes për shtetasin e huaj, nëse kjo është e nevojshme.

5. Autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin, brenda 3 (tre) ditësh pune, referuar vlerësimeve sipas pikës 4, vendos për miratimin ose refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi ose leje unike.

6. Struktura pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, brenda 2 ditëve pune, njofton të huajin për miratimin e lejes së qëndrimit elektronikisht, duke e informuar për hapat e mëtejshëm.

7. Me qëllim unifikimin e procedurës për mënyrën e përllogaritjes së fillimit të afatit të lejes së qëndrimit/lejes unike, si datë fillimi, pas miratimit nga të gjitha strukturat përgjegjëse, do të jetë data e pajisjes së të huajit me leje provizore.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit ose të lejes unike, ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e kërkesës për pajisje për herë të parë, përjashtuar aplikimin për vizë për kategorinë e shtetasve të huaj që kërkojnë pajisjen me vizë të tipit D, kur aplikojnë për herë të parë.

2. Kërkesat dhe procedurat administrative që preken nga ky udhëzim zbatohen pas përmirësimit të sistemeve elektronike që preken nga këto procedura.

3. Udhëzimi i përbashkët nr. 196, datë 14.10.2024, "Për bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, për procedurat e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt", shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

DREJTOR I SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT
Vlora Hyseni

ANEKSI NR. 1

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

NJOFTIM

Ju njoftojmë se leja e qëndrimit/leja unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr. _____, FID _____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/unike, ju duhet të:

Hapi 1: Konfirmoni adresën e saktë të vendqëndrimit në Zyrën e Gjendjes Civile të bashkisë/njësisë administrative (duke paraqitur brenda 30 ditëve këtë njoftim të printuar, dokumentin e udhëtimit dhe dokumentin e pronësisë së banesës/kontratë qiramarrje/kontratë huadhënie).

Hapi 2: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike, duke blerë kuponin në filialet e Postës Shqiptare.

Hapi 3: Paraqituni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Komisariatin e Policisë Kufitar dhe Migracionit _____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Specialisti i Migracionit _____

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin/Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit _____

NOTE

We inform you that your Residence Permit/Single Permit for citizens _____, Travel Document no. _____, FID _____ has been approved.

To issue a biometric document Residence Permit/Unique Permit, you need:

***Step 1:** Confirm the correct residential address at the Civil Registry Office* of the municipality/administrative unit *(submitting this printed notice, travel document and* the property Ownership document/rental agreement/lending contract within 30 days*).*

***Step 2:** Make the payment for the biometric card by purchasing a coupon at the branches of the Post Office.*

***Step 3:** Be present at the Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*

Thank you for understanding!

_____

Migration Specialist _____ *Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat* _____

ANEKS NR. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA RAJONALE E KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

REFUZIM/HEQJA E LEJES SË QËNDRIMIT/LEJES UNIKE
REFUSAL/WITHDRAWAL OF RESIDENCE PERMIT/UNIQUE PERMIT

Më , në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin
On at the Regional Directorate for Border and Migration

□ I refuzohet leja e qëndrimit shtetasit: *The citizen's residence permit is refused:* □ I hiqet leja e qëndrimit shtetasit: *The citizen's residence permit is revoked:*

Mbiemri *Family name*

Emri *First name*

Datëlindja *Date of birth*	Vendlindja *Place of birth*	Gjinia *Sex*
Shtetësia *Nationality*	Banues në *Resident in*	
Dokumenti i udhëtimit nr. *Travel document no.*	Lëshuar në *Issued in*	Më *on*

në mbështetje të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt" të ndryshuar, për arsyet në vijim:
based on Law No. 79/202, "On Foreigners", as amended, for the following reasons:

□ **A.** Ka shkelur afatet e aplikimit për leje qëndrimi pa motiv (neni 34/1(a), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
Groundless violation of the time limit for residence permit application (Article 34/1(a) of Law No. 79/2021 "On Foreigners", as amended).

□ **B.** Nuk plotëson kushtet e nevojshme për qëndrim (neni 34/1(b), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar) referuar:
The applicant _____ (Article 34/1(b) of Law No. 79/2021 "On Foreigners", as amended).

□ **C.** Përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike dhe është subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë (neni 34/1(c), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
The applicant is a threat to public order and security, and he is subject to removal from the territory of the Republic of Albania (Article 34/1(c) of the Law No. 79/2021, "On Foreigners", as amended).

□ **Ç.** Nuk ekzistojnë me arsyet për të cilat është lëshuar leja e qëndrimit (neni 34/1(d), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
The reasons for which the residence permit is issued no longer exit (Article 34/1(d) of Law No. 79/2021, "On Foreigners", as amended).

□ **D.** Ka qëndruar mbi 180 ditë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (neni 34/1(e), i ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar).
The applicant _____ (Article 34/1(e) of Law No. 79/2021 "On Foreigners", as amended).

Komente/Comments

Personi i interesuar mund të ankohet ndaj vendimit për refuzimin e lejes së qëndrimit, sipas parashikimeve të ligji nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, dhe parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

The person concerned may appeal against the decision refusing the resident permit as provided for in the law No.79/2021 "On Foreigners", as amended" and in the provisions of the Albanian legislation.

Personi i interesuar **Autoriteti**

Person concerned *Authority*